



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2021:216935

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06773955

Rev.nr.603/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Zenel Leku dhe Lumni Sallauka, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: E.R., E2. S., F. Z., F. Sh. dhe H. H., nga Gj., të cilët i përfaqëson Labinot Buzuku avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar B. M. nga Gj., sipas autorizimit, për kompensimin e diferencës së pagave, gradim - licencim, dhe inflacion, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2008/2023, të datës 08.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.01.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. PRANOHET revizioni i paditësve: E2. S. dhe F. Z., të dy nga Gj., Priset aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2008/2023, i datës 08.10.2024, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim.

II. HEDHET POSHTË i palejuar revizioni i paditësve: E. R., F. Sh.dhe H. H., të tre nga Gj., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2008/2023, të datës 08.10.2024.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1258/21 të datës 27.01.2023, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve E. R., E2. S., F. Z., F.Sh. dhe H. H., e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit Enver Rexhepi, në

emër të inflacionit për periudhën kohore nga data 28.09.2018 deri më 30.09.2022, për 48 muaj t'ia paguaj shumën prej 383.24 €, paditësit E2.S., në emër të inflacionit për periudhën kohore nga data 28.09.2018, deri më 30.09.2022, për 48 muaj t'ia paguaj shumën prej 514.68 €, paditësit F. Z. në emër të inflacionit për periudhën kohore nga data 28.09.2018 deri më 30.09.2022, për 48 muaj t'ia paguaj shumën prej 616.17 €, paditësit F. Sh. në emër të inflacionit për periudhën kohore nga data 28.09.2018 deri më 30.09.2022, për 48 muaj t'ia paguaj shumën prej 383.24 €, paditëses H. H. në emër të inflacionit për periudhën kohore nga data 28.09.2018 deri më 30.09.2022, për 48 muaj t'ia paguaj shumën prej 383.24 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2021, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit. II. Refuzohet në tërësi si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëseve përtej shumës së gjykuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim/fakultet, për periudhën kohore nga data 28.09.2018 deri më datë 30.09.2022, për 48 muaj, t'ia paguaj shumën si në vijim për paditësin E.R. shumën prej 2, 898 €, për paditësin E2.S. shumën prej 3, 756.60 €, për paditësin F. Z. shumën prej 4,741.83 €, për paditësin F. Sh. shumën prej 2, 898 €, dhe për paditësen H. H. shumën prej 2, 898 €. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2008/2023, të datës 08.10.2024, është vendosur: Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësve E. R., E2. S., F. Z., F. Sh. dhe H. H., nga Gj., dhe e të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1258/21 datë 27.01.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i paditësve në tërësi si i bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve, si dhe ti njihen shpenzimet e procedurës kontestimore.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësve E2. S. dhe F.Z. është i bazuar.

Revizioni i paditësve E.R., F.Sh. dhe H. H. është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, më datë 28.09.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e diferencës së pagave, gradim - licencim, dhe inflacion, duke kërkuar më saktësisht si në parashtrësën për ndryshimin/zmadhimin e padisë së datës 24.01.2024.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të shkresave tjera

të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1258/21 të datës 27.01.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Listën e pagave me numër EM ..., EM ..., EM ..., EM ..., EM ..., kontratën e punës për mësimdhënese në kohë të pacaktuar me numër ..., licencën e mësimdhënësit me numër ..., diplomën e kualifikimit universitar me numër ... të datës 30.10.2009, në emër të E.R., kontratën e punës për mësimdhënese në kohë të pacaktuar me numër ..., licencën e mësimdhënësit me numër ..., vendimin me numër ... të datës 29.03.2013, certifikatën e datës ..., diplomën e kualifikimit universitar me numër ... të datës 02.07.1997, në emër të E2.S., kontrata e punës për mësimdhënese në kohë të pacaktuar me numër ..., licencën e mësimdhënësit me numër ..., diplomën e kualifikimit universitar me numër ... të datës 02.12.1998, në emër të F. Z., kontratën e punës për mësimdhënese në kohë të pacaktuar me numër ..., licencën e mësimdhënësit me numër ..., diplomën e kualifikimit universitar me numër ... të datës 15.01.2002, në emër të F. Sh., certifikatën e vendbanimit me numër B ... të datës 16.12.2011, kontratën e punës për mësimdhënese në kohë të pacaktuar me numër ..., licencën e mësimdhënësit me numër ..., ekspertizën financiare të datës 27.12.2022.

Ka shtuar se gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësve dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, dhe të datës 22.01.2021, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi, neni 35 i kontratës në fjalë, nga paragrafi 4 e deri në paragrafin 10, ka rregulluar sistemin e pagave sa i përket orës mësimore mbi normë, shpenzimeve të rrugës, shtesës për përvojën e punës, kompensimit për ushqim gjatë punës, shpërblimit jubilar, pagave përcjellëse dhe shkallës së inflacionit, duke specifikuar saktësisht në këto paragrafe se mësimdhënësit i paguhen këto shpenzime/kompensime, e në këtë rast këtu edhe rrjedh obligimi i të paditurës në kompensimin e kërkesës së paditësve. Gjukata vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me kërkesën për inflacion bazuar në nenin 35 paragrafi 10 të po kësaj kontrate i cili ka paraparë shprehimisht se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë”, se në rastin konkret të gjithë paditësit i plotësojnë kushtet për kompensim sipas dispozitave lartcekura në njërin anë e në anën tjetër një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë. Gjukata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që licencimi sipas nenit 7 të kësaj kontrate, gjykata vlerëson se nuk ka karakter detyrues për shpërblim të së njëjtës nga pala nënshkruese, këtu e paditura, pasi në këtë nen është përcaktuar mundësia e kualifikimit të mësimdhënësve, e cila rrjedhë sipas legjislacionit të punës dhe legjislacionit për arsim në fuqi, ndërsa nga Ligji i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë Parauniversitar e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë, gjykata nuk ka gjetur se është paraparë obligim për ngritjen e shkallës së pagës, sipas licencimit-kualifikimit, konkretisht neni 7 i KKAK-së, nuk ka karakter imperativ dhe si i tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit, gjykata vlerëson se përcaktimi në aktet ligjore dhe nënligjore për

ngritjen e shkallës së pagës është kusht që duhet plotësuar, në mënyrë që të merrë karakterin detyrues ky nen, siç e thekson edhe paragrafi 3 i nenit 35 të kontratës kolektive se pagat e punonjësve të arsimit përcaktohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa ky kusht shihet se nuk është plotësuar, andaj i njëjti nen ka karakter deklarativ për palët nënshkruese, për më tepër këtë detyrim nuk e parasheh as UA, ku në nenin 17 janë përcaktuar punët dhe detyrat e secilit nga 9 faktorët e pjesëmarrjes në licencim.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 7, 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017. Për shpenzimet e procedurës iu ka referuar nenit 452 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësit kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.2008/2023, të datës 08.10.2024, ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësve si të pabazuara, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë ta vërtetojë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së dytë është dashur të priset.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragraf 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pra kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet thelbësore të ngritura nga pala paditëse e që kanë të bëjnë me çështjen në emër të diferencës në pagë, për punonjës in me licencim/fakultet, për periudhën kohore nga data 28.09.2018 deri më datë 30.09.2022, për 48 muaj, të cilët i janë referuar me ankesë vendimin të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008, si dhe pretendimeve në raport me shpenzimet e procedurës. Po ashtu në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë nga pala paditëse, as në aspektin e shkeljeve esenciale të

dispozitive procedurale si dhe as në aspektin e aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Kjo mënyrë e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë është në kundërshtim me nenin 204 të LPK, i cili ka përcaktuar si obligim për gjykatën e shkallës së dytë që t'i vlerësoj pretendimet ankimore të palëve e të cilat kanë qenë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

Sipas kësaj gjykate, nuk mjafton që gjykata e shkallës së dytë vetëm të konstatoj se nuk ekzistojnë këto shkelje dhe ta përsëritë formulimin e dispozitës ligjore, por është obligim që të paraqes arsye të qarta në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar nga pala. Duhet pasur parasysh se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Sipas kësaj gjykate, nuk janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e shkallës së dytë në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e diferencës në pagë, për punonjësin me licencim/fakultet.

Gjykata e shkallës së dytë në rigjykim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë të gjitha pretendimet e paditësve me ankesë dhe pastaj të arsyetoj për të gjitha pretendimet ashtu siç e parashohin dispozitat ligjore të LPK-së, dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Sa i përket pikës së II, të dispozitivit me të cilën është hedhë poshtë si i pa lejuar revizioni i paditësve: E. R., F. Sh. dhe H. H., Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike - kontestimore fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e revizionit dhe konstatoi se në këtë rast revizioni është i palejueshëm, për arsye se:

Me nenin 218, të LPK-së, dhe nenin 11, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 218 i ligjit bazik, përcaktohet se: “1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. 2. Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet ”.

Me nenin 211 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk kalon 3,000 € ”, ndërsa në paragrafin 4, të këtij neni përcaktohen përjashtimet, si: “ Përjashtimisht edhe kur bëhet fjalë për kërkesëpadinë nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar: a) në kontestet për ushqim, b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur për shkak të vdekjes së dhënies së

ushqimit dhe c) ndaj kontestet ndaj marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2008/2023, të datës 08.10.2024, sa i përket paditësve të lartcekur për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 3,000 €, për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese. Në këtë rast vlera e kontestit në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë nga gjykata e shkallës së parë për paditësit për secilën kërkesë veç e veç është dhe atë: për paditësin E. R. shumën prej 2,898 €, për paditësin F. Sh. shumën prej 2,898 €, dhe për paditësen H. H. shumën prej 2,898 €, e cila nuk e kalon shumën prej 3,000 €, dhe po ashtu natyra e kontestit nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e revizionit (përjashtimet pavarësisht vlerës), prandaj në këtë rast për shkak të vlerës së kontestit, revizioni është i palejuar.

Përveç të cekurave në këtë çështje kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqës të thjeshtë, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale të bashkëndërgjysëve tjerë. Në bazë të nenit 268 të LPK-së, çdo njeri nga këta është i pavarur në gjykim dhe se vlera e kontestit merret veç e veç për çdo njeri prej tyre.

Andaj më qenë se gjykata e shkallë së parë nuk e ka hedh revizionin e të paditurës ashtu siç përcaktohet me nenin 218 të LK-së, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 221 të LPK-së, vendosi që ta hedhë poshtë si të palejueshëm revizionin.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 221 dhe 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Rev.nr.603/24, datë 27.01.2025.

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi